


REZULTATET KRYESORE TË PROJEKTIT



TRAJNIME PËR RRITJE KAPACITETESH

2

ACER dhe AIS organizuan dy trajnime për të pajisur organizatat e shoqërisë civile me aftësitë për të zbatuar në mënyrë të pavarur Metodologjinë për Vlerësimin Parandalues për Korrupsion, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

AFTËSITË E FITUARA

- Njohje e fazave të hershme ligjvënëse për të identifikuar pikat e ndërhyrjes së OJF-ve.
- Aftësi për të monitoruar projektligjet dhe vlerësuar rreziqet për korrupsion.
- Bashkëpunim me deputetët dhe komisionet për prezantimin e opinionëve të bazuar në CPL.
- Mentorim nga AIS dhe ACER për hartimin e opinionëve ligjorë pas trajnimit të qershorit 2025.



MODULET KRYESORE

- Procesi legjislativ: Mbulon fazat e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve në Kuvend, duke theksuar pikat ku OJF-të mund të ndërhyjnë.
- Vlerësimi parandalues i akteve ligjore: Fokus në analizën preventive të projektligjeve për hapësira abuzimi, me praktika për hartime opinionesh.
- Moduli i Procesit Ligjvënës në trajnimet: Fuqizon OSHC-të me njohuri për fazat e hartimit dhe miratimit të projektligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.



MODELI I MENTORIMIT

- Asistencë teknike: Ekspertë të fushës ofrojnë udhëzime për analizën e projektligjeve duke përdorur metodologjinë CPL për identifikimin e rreziqeve potenciale për korrupsion.
 - Mbështetje në hartim: Asistencë për strukturimin e opinionëve analitike dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësime ose modifikime ligjore.
- Përgatitje për prezantim: Trajnim për paraqitjen dhe dorëzimin e opinionëve pranë komisioneve parlamentare.

REZULTATET




**8 OSHC të
trajnuara
3 CPL**

Ky mentorim ka lejuar 11 ekspertë nga 8 OSHC-të të prodhojnë dhe dorëzojnë tre opinionë ligjorë, duke fuqizuar kontributin e tyre në cilësinë e legjislacionit. Është projekt-bazuar dhe ofrohet falas për OSHC-të e certifikuar nga trajnimi.



REZULTATET KRYESORE TË PROJEKTIT



3

OPINIONE CPL PËR PROJEKTLIGJET



Gjatë këtij projekti janë dhënë opinione vlerësimi parandaluese (CPL) për 3 projektligjet e analizuar, duke u fokusuar në mjedisin dhe mbetjet, integritetin publik, dhe teknologjinë e inovacionit, për të mbështetur përmirësimin e politikave dhe praktikave legislative.

3

PROJEKTLIGJET E ANALIZUARA

- "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore
- "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje
- "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike"

Për të verifikuar zbatimin e rekomandimeve të AIS dhe ACER nga opinionet CPL, mund të konsultohen dokumentet zyrtare që tregojnë ndryshimet mes versionit fillestar dhe atij përfundimtar të projektligjeve.



REKOMANDIME

- Rikthimi për konsultim publik i projektligjeve për të siguruar përfshirje më të gjerë të palëve të interesit.
- Hartimi paraprak i akteve nënligjore, për të garantuar zbatim të qartë dhe efektiv të ligjit.
- Rritja e transparencës dhe përafrimi me standardet e BE-së gjatë procesit legjislativ.

Nga krahasimi i versioneve të projektligjeve rezulton se rreth 15–30% e rekomandimeve të AIS dhe ACER nga opinionet CPL janë reflektuar në ligjet e miratuara.

NDIKIMI

ACER dhe AIS në bashkëpunim me Westminster Foundation for Democracy (WFD), kanë kontribuar në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe vlerësimit antikorrupsion të legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë. Opinionet kanë gjeneruar mbulim mediatik dhe debat publik mbi transparencën dhe integritetin e procesit ligjvënës.

